

RRETHI KORÇË

“XH.F. KACOS” SH.P.K me NIPT: L54008001D

Adresa: Ndërtesë private, Nr. i pasurisë 510/40, Zona kadastrale 2973, Rr. “Korçë – Bilisht, Km 4”, Belorta, Korçë, Tel: 0698616323

V E N D I M

Nr. 9/1 Datë 03.11.2022

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË “XH.F. KACOS” SH.P.K.

Objekti: MIRATIMI I ANALIZËS SË AKTIVITETIT TREGTAR PËR PERIUdhËN JANAR-GUSHT 2022 DHE I PROCEDURAVE TË KRYERA PËR ZMADHIMIN NË VLERË TË KAPITALIT TË SHOQËRISË “XH.F. KACOS” SH.P.K.

Sot, më 03.11.2022 konform ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 (neni 44) dhe ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” (nenet 81-97 dhe 127) si dhe mbështetur në normat e Akt-Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “XH.F. KACOS” SH.P.K, me seli: Ndërtesë private, Nr. i pasurisë 510/40, Zona kadastrale 2973, Rr. “Korçë – Bilisht, Km 4”, Belorta, Korçë; regjistruar me NIPT-in: L54008001D, u mbledh “Asambleja e Ortakëve” e përfaqësuar nga “Ortaku i vetëm, zoti Xhuliano Kacos”. Në mbledhje morën pjesë edhe disa punonjës të tjerë të punësuar në këtë shoqëri tregtare.

Zoti Xhuliano Kacos, në cilësinë e “Asamblesë së Ortakëve” mori në analizë aktivitetin tregtar të realizuar gjatë periudhës Janar- Tetor 2022, miratimin e Pasqyrave paraprake Financiare për këtë periudhë të vitit 2022 dhe domozdoshmërinë për “Zmadhimin e Kapitalit të kësaj shoqërie tregtare”.

Ortaku i vetëm i shoqërisë “XH.F. KACOS” SH.P.K, zoti Xhuliano Kacos në cilësinë e “Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve” të shoqërisë tregtare “XH.F. KACOS” SH.P.K, pasi analizoi projekt-propozimet dhe materialet shkresore të hartuara për zgjidhjen e problemeve të mësipërme

REALIZOI:

Diskutimin dhe miratimin e analizës së veprimtarisë ekonomike e financiare për periudhën 01.01.2022 deri më 31.10.2022, sipas objektivave të përcaktuara paraprakisht dhe sipas Pasqyrave paraprake Financiare të shoqërisë të hartuara për periudhën deri më 31.10.2022, veçanërisht për inventarin e AAM-ve (Aktiveve Afatgjata Materiale), gjendjen e mallrave, të lëndëve të para, të materialeve ndihmëse, mënyrën e evadimit sa më të shpejtë të tyre e të tjera.

Zmadhimin e Kapitalit në vlerë duke pasur si burim “Fitimet neto të realizuara të mbartura deri më 31.12.2021 dhe Fitimet Neto të deklaruara në Bilanc që përfshijnë periudhën deri më 31.12.2021”.

Miratimin e vijueshmërisë së llogarive gjatë vitit 2022, rezultatin e tyre më 31.10.2022, çeljet e tyre për aktivitetin tregtar që fillon më 01.01.2022 dhe detyrat për vazhdimësinë e punës për periudhën e ardhshme të vitit 2022.

Strukturimin e Kapitaleve, shpërndarjen e Fitimeve të mbartura nga vitet e kaluara dhe krijimin e Rezervës Ligjore e Statutore konform kërkesave të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (nenet 81-97 e 127).

Diskutimin dhe analizën e strukturës së kapitalit për ta shndërruar projekt-vendimin për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “XH.F. KACOS” SH.P.K në vendim.


Zoti Xhuliano Kacos (ortak i vetëm) në cilësinë e “Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve” në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “XH.F. KACOS” SH.P.K, pasi analizoi materialet shkresore dhe dokumentet e mësipërme:

VENDOSI:

Të miratohet pa vërejtje raporti për analizën e veprimtarisë ekonomike e financiare për periudhën raportuese 01.01.2022 deri më 31.10.2022, sipas objektivave të përcaktuara paraprakisht dhe sipas Pasqyrave paraprake Financiare të shoqërisë “XH.F. KACOS” SH.P.K të hartuara për vitin ushtrimor deri më 31.10.2022, bashkë me inventarin e AAM-ve (Aktiveve Afatgjata Materiale) dhe të materialeve të tjera të paraqitura në “Pasqyrat Aneksë të bilancit paraprak”.

B-. Të miratohet procedura për Zmadhimin e Kapitalit në vlerë për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “XH.F. KACOS” SH.P.K (në të cilën vlerat totale të burimeve të zmadhimit të kapitalit janë (Fitimet e mbartura në vite në vlerën 0.00 lekë plus fitimi i vitit ushtrimor të realizuar gjatë vitit 2021 të cilat shprehen në vlerën 19,382,945.00 lekë). Rezervat e kapitalit nuk do të paksohen por vetëm do të shtohen nga ndryshimet që do të ndodhin.

C-. Të miratohen lëvizjet në Kapitalin e vet të shprehura në tabelën e mëposhtme në mënyrë të përmblendhur dhe me specifika të veçanta për lëvizjet në Kapitalin që është “Pronë e shoqërisë” bazuar në përcaktimet specifike të hollësishme të sipërcituara që konkretisht materializohen në tabelën e mëposhtme.



GJENDJA AKTUALE E LLOGARIVE TE KAPITALIT ME 31.12.2021, NDRYSHIMET DHE STRUKTURA E GJENDJES SE KAPITALIT QE DO TE KETE SHOQERIA TREGTARE "XH.F.KACOS" SH.P.K ME 03.11.2022.

Numer i llogarisë	Emertimi i llogarise	Njesia masese	Gjendja e llogarive të kapitalit të shoqërisë më 31.12.2021	Ndryshimet e strukture së vlerës së llogarive të kapitalit që kerkohen te ndryshohen		Struktura e llogarive të kapitalit të shoqërisë që kërkohe për miratim më 03.11.2022
				Shtesa	Paksime	
101	Kapitali i paguar	LEK	54,000,000.00	16,000,000.00		70,000,000.00
1071	Rezerva ligjore	LEK	5,400,000.00	1,600,000.00		7,000,000.00
1073	Rezerva statutore	LEK	2,700,000.00	800,000.00		3,500,000.00
1078	Rezerva të tjera	LEK	2,190,772.00	982,945.00		3,173,717.00
108	Fitimi/Humbja e pashperndare	LEK	-			-
109	Fitimi neto I vitit ushtrimor 202021	LEK	19,382,945.00	-	19,382,945.00	-
	SHUMA		64,290,772.00	19,382,945.00	19,382,945.00	83,673,717.00

D-. Të miratohet pa vërejtje raporti dhe analiza e paraqitur nga stafi i drejtimit të shoqërisë , për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "XH.F KACOS" SH.P.K.

E-. Projekt-propozimi i paraqitur prej stafit të drejtimit për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "XH.F KACOS" SH.P.K të materializohet dhe të bëhet vendim duke ndryshuar strukturën e Kapitalit "Pronë e shoqërisë" të deklaruar në Bilancin e aktivitetit tregtar të mbyllur për vitin 2021, e cila përfundimisht do të jetë:

GJENDJA E LLOGARIVE TE KAPITALIT DHE STRUKTURA E TIJ E CILA MIRATOHET ME "VENDIM TE ASAMBLESE TE ORTAKEVE ME DATE 03.11.2022.

Numeri i llogarise	Emertimi i llogarise	Njesia matse	TE DHENAT NE LEK	
			Debi	Kredi
101	Kapital themeltar i paguar	lek	-	70,000,000.00
1071	Rezerva ligjore	lek	-	7,000,000.00
1073	Rezerva statutore	lek		3,500,000.00
1078	Rezerva të tjera	lek		3,173,717.00
108	Fitimi/Humbja e pashperndare	lek	-	-
109	Rezultati i ushtrimit	lek	-	-
	SHUMA E KAPITALEVE TE VETA	lek	-	83,673,717.00

F-. Lëvizjet në kapital të shprehura me fjalë miratohen pa vërejtje në kontekstin sa më poshtë vijon:

1.Kapitali aksioner nga 54,000,000.00 lekë rritet me 16,000,000.00 lekë me burim "Fitimet neto të mbartura dhe Fitimin neto të realizuar gjatë vitit 2021" dhe përfundimisht shoqëria tregtare "XH.F. KACOS" SH.P.K do të ketë nje Kapital të derdhur, të nënshkruar në masën 70,000,000.00 (shtatëdhjetë milion).lekë, i cili vlerësohet me një kuotë (e shprehur ndryshe 100%) në pronësi të zotit Xhuliano Kacos.

2.Rezervat Ligjore do të ndryshojnë. Nga 5.400.000.00 lekë që kanë qenë, ato do të rriten me 1.600,000.00 lekë dhe përfundimisht ato do të jenë 7.000,000.00 (shtatë milion) lekë.

3.Rezervat Statutore do të ndryshojnë. Nga 2,700.000.00 që kanë qenë , do të rriten me 800.000.00 lekë dhe përfundimisht do të jenë në vlerën 3.500,000.00 (tremilione pesëqind mijë) lekë.

4.Rezervat e Tjera do të ndryshojnë. Nga 2,190,772.00 lekë që kanë qenë, do të rriten 982,945.00 me lekë dhe përfundimisht ato do të jenë 3,173,717.00 (tremilion e njëqind e shtatëdhjetë e tremijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

5.Fitimet e Pashpërndara në llogarinë 108 paksohen me 19,382,945.00 lekë dhe përfundimisht ato do të jenë në masën 0.00 (zero) lekë.

6. Fitimi neto i realizuar gjatë vitit 2021 i cili me Vendimin Nr 78 datë 27.06.2022 në vlerën 19,382,945.00 lekë ka shkuar për zgjerimin e aktivitetit tregtar "si fitim i pa shpërndarë" dhe më pas me këtë vendim kjo vlerë kalon në kapitalin aksioner dhe në rezerva. Ky fitim paksohet me këtë vlerë ndërsa llogaria 109 mbetet në vlerën 0 (zero) lekë.

Ky Vendim të depozitohet në QKB brenda datës 3 Nentor 2022 nëpërmjet procedurës së aplikimit në QKB nga Administratorja e shoqërisë tregtare "XH.F. KACOS" SH.P.K, nga administratorja, Zj. Esmeralda Lara..

PËR SHOQËRINË TREGTARE "XH.F. KACOS" SH.P.K
ORTAK I VETËM I SHOQËRISË
XHULIANO KACOS

